

MODUL TRAJNIMI 1 DITOR “MENAXHIMI I KARRIERËS DHE BRAND-imi PERSONAL”

Pse duhet të ndiqni modulën e trajnimit “Menaxhimi i karrierës dhe brand-imi personal”?

Shumë prej nesh investojnë në dije por pak syresh arrijnë të prezantojnë si duhet aftësitë e tyre dhe për më tepër të krijojnë individualitetin e tyre duke menaxhuar jo vetëm karrierën e tyre por edhe duke e kthyer profesionalizmin e tyre në një brand. Ky trajnim ka për qëllim të familjarizojë profesionistët e rinj me trajektoret e karrierës si dhe me aftësitë e nevojshme për të patur një karrierë të suksesshme. Menaxhimi i Karrierës është një proces i vazhdueshëm që ju lejon të përshtateni me kërkesat e vazhdueshme të ekonomisë dhe tregut. Në këtë trajnim, procesi i menaxhimit të karrierës përfshin koncepte të ndryshme: Vetë-ndërgjegjësimi, planifikimi i zhvillimit të karrierës / eksplorimi i karrierës, mësimi gjatë gjithë jetës dhe rrjetëzimi.

Kush e ofron trajnimin?

Moduli i trajnimit ofrohet nga AM-Barleti Human Capital dhe Akademia e Punësimit dhe Karrierës. AM-BHC është themeluar mbi disa vlera thelbësore si promovimi i standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare të cilësisë në tregun e punës, krijimin e një mjedisi dinamik dhe konkurrues që nxit zhvillimin në nivel individual, profesional dhe komunitar, duke pasur në fokus punësimin, fuqizimin e kapitalit njerëzor, mbështetjen për sipërmarrjen si dhe përputhjen e aftësive me talentet dhe me kërkesat e çdo punëmarrësi dhe punëkërkuari.

Çfarë përman ky modul trajnimit?

Trajnimi mbi Menaxhimin e Karrierës është konceptuar që të jetë shumë interaktiv, duke përdorur një përzierje të rasteve studimore, ushtrimeve me role, pyetësorëve të vetëvlerësimit, prezantimeve dhe seminareve, diskutim në grup etj. Ai paraqet një mundësi për ju që të praktikoni aftësitë e mësuara duke përdorur një larmi ushtrimesh praktike që bazohen në materialet gjithëpërfshirëse.

Tematikat që do të shtjellohen gjatë trajnimit

- Të njohësh mirë vetveten. Një analizë e interesave, aftësive, vlerave dhe llojit të personalitetit për të gjetur drejtimin e karrierës që të përshtatet më shumë
- Planifikimi i karrierës dhe eksplorimi i karrierës
- Strategjitë e menaxhimit të karrierës
- Të mësuarit përgjatë gjithë jetës- Përshtatja e vazhdueshme me aftësitë që kërkon tregu i punës
- Ndërtimi i marrëdhënieve dhe rrjeteve të bashkëpunimit për të pasur një karrierë të suksesshme.
- Vështirësitë kryesore në menaxhimin e karrierës

Aftësitë dhe kompetencat e fituara në mbyllje të trajnimit

Në përfundim të këtij trajnimit pjesëmarrësit do të jenë të aftë të: njohin më mirë aftësitë dhe preferencat e veta sa i përket profesionit dhe karrierës; të përdorin disa teknika bashkëkohore për

planifikimin e karrierës; të ndërtojnë marrëdhënie në funksion të karrierës; të menaxhojnë më mirë sfidat në karrierë etj.

Kujt i adresohet ky trajnim?

Ky trajnim ju shërben profesionistëve të rinj të cilët duan të planifikojnë sa më mirë karrieren e tyre si dhe të gjithë profesionistëve më me eksperiencë të cilët duan ta riorientojnë veten dhe karrieren e tyre në tregun e punës.

Si realizohet ky modul trajnimi?

Moduli i trajnimit realizohet në auditoret e Universitetit “Barleti” së paku 1 herë në muaj, me grupe jo më shumë se 15 persona. Në kushtet e pandemisë së shkaktuar nga COVID – 19 trajnimi mund të realizohet dhe online nëpërmjet platformës së mundësuar nga UniBA dhe BTTC. Ky modul trajnimi ofrohet nga trajnerë dhe pedagogë me një eksperiencë shumëvjeçare dhe rekorde tepër pozitive në fushën e menaxhimit të cilët përdorin metodat dhe teknologjitë më të fundit duke ilustruar më së miri trajnimin.

Kohëzgjatja & Certifikata:

Ky modul trajnimi ofrohet në auditor ose online me një kohëzgjatje 1 ditore. Në fund të trajnimit lëshohet një certifikatë nga AM-Barleti Human Capital në bashkëpunim me Barleti Training and Testing Center (BTTC). Kjo certifikatë është e njohur dhe nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive si dhe QKL.

Për interesim dhe rregjistrim lutem na kontaktoni në:

E-mail: administrator@humancapital.al

Tel: +355 69 21 55 745

Homepage: www.humancapital.al